



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant: **Specialist** në Drejtori Rajonale / Dega e Shërbimeve Mbështetëse / Sektori Ligjor.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për përfaqësimin e çështjeve gjyqësore.
- Përgjegjës për hartimin dhe ndjekjen e kallzimeve penale pranë organeve të ndjekjes penale.
- Përgjegjës për ndjekjen pranë Zyrave Përmbartimore përkatëse të procedurave për ekzekutimet e vendimeve gjyqësore.
- Ndihmon në dhënien e asistencës ligjore strukturave të shoqërisë në drejtim të njohjes, interpretimit dhe zbatimit rigoroz të ligjit, akteve nënligjore si dhe urdhrave të Drejtuesve të shoqërisë.
- Harton raporte mujore për ecurinë e konflikteve gjyqësore.
- Përfaqësimi i çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit në funksion të mbrojtjes së interesave të shoqërisë në proceset gjyqësore në përputhje me legjislacionin në fuqi duke vepruar me profesionalizëm dhe besnikëri.
- Hartimi dhe ndjekja e kallzimeve penale pranë organeve të ndjekjes penale
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Fakultetin e Drejtësisë me rezultate të mira.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet.
- Të mos ketë marrë masë disiplinore nga punëdhënësi i fundit, për një periudhë kohore 1 vjeçare, nga momenti i aplikimit për punësim pranë Drejtorisë Ligjore të OSHEE sh.a.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.
- Të njohë gjuhë të huaja, preferohet gjuha angleze.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.